

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deputetja Sala Jashari: Kuvendi i Kosovës duhet të nisë procedurat për zhbërjen e Gjykatës Speciale të Hagës
ADRESA	https://kohajone.com/kryesore/kuvendi-i-kosoves-duhet-te-nise-procedurat-per-zhberjen-e-gjykates-speciale-te-hages/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:59:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:55:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7ba881ef8b8071304d805d027da143fd32b91ffd812b5db5723cb734cd48322
TEKSTI	f69cbb076d6081ed2fe132b01cb9ee363fd34ed3e14010480358ee859b49e846
PAMJA	ec979dea496df350bb05826cb00ceeda68371d756767c4481bc97be20e5bc660

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5b3b55ab87cb169b16fc1e0293cc1b3f481010c832691561ecd36ea306d6f92d
E MËPARSHMJA	62ffe5b091e0295ffe998ff6f0fe7efb7a326d99baa198f4b2e00331b102af73
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5b3b55ab87cb169b16fc1e0293cc1b3f481010c832691561ecd36ea306d6f92d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Deputetja Sala Jashari: Kuvendi i Kosovës duhet të nisë procedurat për zhbërjen e Gjykatës Speciale të Hagës

KRYESORE E MËRKURË, 16 SHTATOR 2026 19:55



Pas vendimit të rëndë ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, Kuvendi i Kosovës nuk mund të qëndrojë më në heshtje. Nëse hesht pas kësaj që ndodhi sot atëherë tradhtia mbetet e Albin Kurtit.

Thirrja e deputetes së PDK-së, Sala Jashari, për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme dhe nisjen e procedurave institucionale për zhbërjen e Gjykatës Speciale duhet të merret seriozisht nga të gjitha partitë shqiptare.



KOHA JONË
Na ndiqni në YouTube



Gjykata u krijua nga vetë Kuvendi i Kosovës në vitin 2015, nën një tryzni të jashtëzakonshme ndërkombëtare. Deputetëve të atëhershëm iu tha se krijimi i saj ishte i domosdoshëm për të dëshmuar se Kosova nuk kishte asgjë për të fshehur dhe se drejtësia do të ishte e paanshme. Edhe ish-drejtesit e UÇK-së u paraqitën vullnetarisht përpara saj, me bindjen se e vërteta do të triumfojë.

Por pas vendimit të sotëm, institucionet e Kosovës kanë të drejtën dhe detyrimin të pyesin: a u krijua kjo gjykatë për të hetuar përgjegjësi individuale apo për të vendosur në bankën e të akuzuarve historinë e UÇK-së? Formalisht, trupi gjykues deklaroi se nuk po gjykonte legjitimitetin e UÇK-së dhe luftën për pavarësi. Në realitet, kur dënohen me burgime të gjata pothuajse të gjithë drejtuesit kryesorë politikë dhe ushtarakë të luftës, pasoja politike është goditja e vetë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj Kuvendi duhet të mbledhet urgjentisht.

Hapi i parë duhet të jetë miratimi i një rezolute të përbashkët, ku të thuhet qartë se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe çlirimtare dhe se vendimi ndaj individëve nuk mund të përdoret për kriminalizimin e saj.

Por rezoluta nuk mjafton. Kuvendi duhet të krijojë një komision të posaçëm juridik dhe parlamentar, i cili të shqyrtojë të gjithë veprimtarinë e Gjykatës Speciale: mënyrën e administrimit të provave, standardet e përdorura, kohëzgjatjen e paraburgimit, respektimin e të drejtave të të akuzuarve dhe burimin e materialeve të ardhura nga Serbia.

Më pas duhet të shqyrtohen procedurat kushtetuese dhe ligjore për përfundimin e mandatit të kësaj gjykate. Zhbërja e saj nuk mund të bëhet me një deklaratë politike apo vetëm me shumicë të zakonshme. Gjykata mbështetet mbi nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës, mbi një ligj të posaçëm dhe mbi detyrime ndërkombëtare të marra nga shteti i Kosovës. Ndryshimi i nenit 162 kërkon shumicën e dy të tretave të të gjithë deputetëve dhe dy të tretat e deputetëve që përfaqësojnë komunitetet joshumicë.

LAJMET KRYESORE



Deputetja Sala Jashari: Kuvendi i Kosovës duhet të nisë procedurat për zhbërjen e Gjykatës Speciale të Hagës



Ben Blushi: Pse u dënua Hashimi?



Vendimi i Hagës, një thikë pas shpine për Kosovën



SHBA reagon pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së: Respektojmë vendimin e gjykatës!



Presidenti Begaj reagon pas vendimit të Gjykatës në Hagë: Trishtim i thellë! Askush nuk e njollos UÇK-në

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Kjo e bën procesin të vështirë, por jo arsyen për të heshtur. Në të njëjtën kohë duhet thënë hapur se edhe shfuqizimi i bazës ligjore të Gjykatës nuk do ta anulonte automatikisht aktgjykimin e sotëm.

Beteja kundër dënimeve duhet të zhvillohet në apel, me një mbrojtje juridike shumë më të fuqishme, me ekspertët më të mirë ndërkombëtarë dhe me mbështetjen e plotë institucionale të Kosovës. Kuvendi duhet të veprojë në dy drejtime: të mbrojtë të drejtat e të dënuarve përmes rrugës ligjore dhe të nisë rishikimin e ekzistencës së një gjykate që ka humbur besimin e shumicës së popullit të Kosovës.

Partitë shqiptare duhet të bashkohen. Kjo çështje është shumë më e madhe se PDK-ja, Vetëvendosja, LDK-ja apo AAK-ja. Ajo prek themelet historike mbi të cilat u ngrit shteti i Kosovës. Kundërshtimi duhet të jetë institucional, demokratik dhe pa dhunë. Çdo trazirë do t'i shërbente vetëm Beogradit dhe do të dobësonte pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

Por heshtja do të ishte po aq e pafalshme. Nëse Albin Kurti dhe LDK heshtin ata po përfitojnë politikisht për vehte, por në realitet tradhetojnë Kosovën. Pas vendimit të sotëm Presidenti Vuçiç dhe krejt shpura serbe u hodh në sulm duke sulmuar UÇK.

Gjykata që u krijua me votën e Kuvendit të Kosovës nuk mund të konsiderohet e paprekshme dhe e përjetshme. Kuvendi që e votoi ka të drejtën të kërkojë llogari, ta rishikojë dhe, përmes procedurave kushtetuese, të vendosë për përfundimin e mandatit të saj. Kosova nuk mund të pranojë që drejtësia të shndërrohet në një mekanizëm për rishkrimin e historisë, duke e poshtëruar Kosovën dhe luftën e saj kundra pushtuesve serbë.

UÇK-ja nuk mund të dënohet në emër të popullit që ajo çliroi.

MË SHUMË NGA KRYESORE



Ben Blushi: Pse u dënua Hashimi?

Vendimi i Hagës, një thikë pas shpine për Kosovën

SHBA reagon pas aktgjyimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së: Respektojmë v...



Presidenti Begaj reagon pas vendimit të Gjykatës në Hagë: Trishtim i ...



Tensione pranë Gjykatës Speciale në Hagë



Vendimi tronditës! Gjykata Speciale dënon Hashim Thaçin, Jakup Krasniq...

LAJMET E FUNDIT



Finlanda publikon listën për Nations League, ja lojtarët që priten ndaj Shqipërisë

[15 MINUTA MË PARË](#)



Meidani pas vendimit të Hagës: Drejtësia e munguar duhet të jepet

[25 MINUTA MË PARË](#)



Deputetja Sala Jashari: Kuvendi i Kosovës duhet të nisë procedurat për zhbërjen e Gjykatës Speciale të Hagës

[34 MINUTA MË PARË](#)





Sara Mila flet te Nikoll Lesi:
"PS-ja nuk ikën nga pushteti".
Në emision u fol edhe për
problemet në PS, ...

49 MINUTA MË PARË



Plagosje me armë zjarri në
Durrës, 61-vjeçari qëllon 52-
vjeçarin pas sherrit

1 ORË E 13 MINUTA MË PARË



Vuçiç ankohehet pas vendimit të
Speciales: Nuk janë dënuar për
krime kundër njerëzimit

1 ORË E 25 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.